



Npi – 01/301 datë: 25.08.2025

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 25.08.2025, është nxjerrë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I Mbledhjes së -VIII- të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
e mbajtur më datën 25.08.2025 (e hënë), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Gëzim Haxhiu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Hasan Avdyli, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Reshat Mujota, z.Rexhep Gashi.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtorat, z.Grejtalb Emini – DPUKGJ, z.Bardhyl Rushiti – DSHP, z.Besnik Ahmeti – DBF, znj.Mimoza Salihu-Qeriqi – DSHMS, z.Valon Januzi- DPP, z.Imri Hoxha - DAP, znj.Anita Kurti Shefe e Kabinetit të Kryetarit, znj.Gentiana Mehmeti, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit, znj.Vlora Hysenaj, Zyrtare për Informim, z.Muhamet Hoxha - RZSH. Praktikantet, znj.Hava Llugaxhiu, znj.Agnesa Ademaj, znj.Admir Selmani, znj.Ilirjana Kadriaj-Halili, znj.Besa Iballi-Qorrolli. Për këtë seancë kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 07.07.2025,
2. Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal 2026-2028 (për diskutim publik),
3. Raporti gjashtëmujor Buxhetor Janar – Qershor 2025,
4. Raporti i Auditimit për Pasqyrën Vjetore Financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2024 nga ZKA,
5. Plani i Veprimit nga Raporti Vjetor i Auditimit të Pasqyrës Vjetore Financiare 2024 për Komunën e Shtimes,
6. Draft – Plani për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin Ferizaj – Gjilan,
7. Pyetje – Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Përshëndetje. Dua të ju njoftojë që e kemi një kërkesë nga OSBE-ja e që është një “Deklaratë mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë” e nxjerrur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në bashkëpunim me OSBE-ë, e nënshkruar edhe nga Presidentja e Republikës së Kosovës, ku OSBE-ja ka kërkuar

që ta fusim në rend të ditës edhe këtë pikë për miratim. Unë e propozoj si pikë e shtatë shtesë. Në vazhdim e hapi diskutimin nëse dikush ka për të shtuar diçka.

znj. Adelina Beqaj: Përshëndetje. Kjo pikë është dashtë me qenë propozim qysh moti. Dua të propozojë që si pikë shtesë të kemi edhe informatë nga DKA për fillimin e vitit shkollor. Dhe pika “Pyetje-Përgjigje” të jetë e dyta.

z. Reshat Mujota: Përshëndetje. Pajtoj me rendin e ditës edhe pse për këtë deklaratë nuk kemi material por e pranoj përsëri. Dua që si pikë shtesë të jetë edhe një sçarim i Komisionit për emërtimin e objekteve publike, dhe të jetë si pikë e parafundit.

z. Muhamet Ademaj: Përshëndetje. E përkrahu rendin e ditës me propozimin e Kryesuesit.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për”, me 7 vota “Kundër”, dhe me 0 vota “Abstenim”, miratoi rendin e ditës me pikën shtesë “Deklaratë mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë”.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 07.07.2025

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj. Adelina Beqaj: Me rregullore të Kuvendit duhet të hidhet për votim propozimi që e bëra. Çfarë po ndodhë me propozimet e mija dhe të Reshatit?

z. Reshat Mujota: Nuk kam çfarë të shtojë por i bëjë thirrje Kryesuesit të Komisionit për emërtimin e objekteve publike z. Ruzhdi Jashari që të jetë prezent në mbledhje te pika Pyetje-Përgjigje.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Këtë çështje e vendos vetëm Kryesuesi e jo dikush tjetër.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 13 vota “Për”, me 0 vota “Kundër”, dhe me 5 vota “Abstenim”, miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 07.07.2025.**

Pika 2

Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal 2026-2028 (për diskutim publik)

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Duhet të ju njoftojë që Komiteti për Politikë dhe Financa ka rekomandu që të miratohet kjo pikë dhe të shkojë në diskutim publik. Fjalën ja dha z. Besnik Ahmetit.

z. Besnik Ahmeti, DBF: Përshëndetje. Më lejoni që para jush të prezantojë këtë Plan Buxhetor. Në vazhdim lexoi materialin si në vijim (shih dokumentin). Ju ftojë të gjithë asamblen dhe qytetarët që të marrin pjesë në diskutim publik, që ky Plan Buxhetor të përgaditet në mënyrën më të mirë të mundshme.

z. Rexhep Gashi: Përshëndetje. Ligji na lejon që ky Plan Buxhetor të shkojë në diskutim publik. Mirëpo unë mendoj që rrugët që janë shtruar tani dhe ndriçimet publike që janë duke u bërë te ky prezantim i Planit Buxhetor Komunal duhet të largohen. Nuk duhet të figurojn në 2026.

z. Muhamet Ademaj: Pajtohem që ky Plan Buxhetor të shkojë në diskutim publik. Pas diskutimit publik e dimë se çfarë kërkesa kanë qytetarët.

z. Besnik Seferi: Përshëndetje. Edhe ligji na udhëzon që të shkojë në diskutim publik ky Plan Buxhetor. Në emër të grupit parlamentar jemi pro që ky Plan të votohet dhe të shkojë në diskutim publik.

* **Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Planin Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2026, për afatin prej 15 ditësh.**

Pika 3

Raporti gjashtëmuor Buxhetor Janar – Qershor 2025

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Fjalën ja dha z. Besnik Ahmetit.

z. Besnik Ahmeti, DBF: Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale si dhe në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisive po e prezantojë këtë raport. Buxheti i Komunës së Shtimes në total është gjithsej 11.040.313.33 euro. Në vazhdim lexoi materialin si

në vijim (shih dokumentin). Gjatë gjashtëmujorit Buxheti është shpenzuar 47.04 % e buxhetit. Ju mirëpres për pyetje.

z.Rexhep Gashi: Faleminderit për elaborimin Drejtor. Aktivitete gjeodezike, çka përfshin ato aktivitete? Te financimi nga huamarrja a ka para që na kanë mbetur ku gjatë kalkulimit e kam parë që kemi mjete por pse nuk i keni futur këtu? Te granti qeveritar janë dy raporte e kemi të vitit 2024 dhe 2025, në raportin e vitit të kaluar e keni dhënë te grantet qeveritare të shfrytëzimet një shumë me 60.2%, në vitin e kaluar ndërsa tash e kemi me 92.21% çka na ka shti te granti qeveritar me shfrytëzu?

z.Muhamet Ademaj: E falenderoj Drejtorin për këtë raport, ky raport ofroj informacione të nevojshme. Jam i pa kënaqur me mos realizimin e disa projekteve. Kërkoj nga Ekzekutivi realizimin e këtyre projekteve: Trotuarin te rruga “Hyrë Emini”, asfaltimit i aneksit te rruga “Kruja” po ashtu asfaltimit i rrugës “Mihal Grameno” në Davidovc, rregullimin e kanalizimit te lagja “Robojve” në Petrovë.

z.Kadri Emini: Përshëndetje. Deshta një sqarim nga DSHP-ja, te taksat për shfrytëzimin e hapësirave publike kemi një ramje në krahasim me vitin e kaluar, a është si arsye e mos pagimit të fakturave nga qytetarët apo çfarë?

znj.Rrezartë Ramadani: Përshëndetje. Kam një pyetje për DSHP-në te raporti i licencave dhe pëlqimeve komunale, a nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët apo nuk i kanë plotësuar kushtet, sepse po më duket e çuditshme të mos jetë asnjë licensim? Gjithashtu te Drejtori i DBF-së nuk po e kuptojë te gjobat në trafik te realizimi Janar-Qershor 2025 është 45,265 euro mirëpo realizimi në raport me planifikimin vjetor është 0%, tu kisha lutë për një spjegim?

znj.Adelina Beqaj: Te realizimi i shpenzimeve i mora disa gjëra të rëndësishme. Është me u çudit se si zhvillimi ekonomik është me 0% shpenzim, pastaj shërbimet e kujdesit primar me 0%, pastaj shërbimet sociale me 0%, arsimin e mesëm dhe fillor me 0% krejt këto janë të dhëna të juaja që ju mi keni dërguar në email për materialin e sotëm si çdo herë me vonesë. Nëse ke mundësi me mi dhënë këto përgjigje.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Sa i përket pyetjes për gjobat, ky raport ka ardhë pas datës që e kemi dërguar materialin për Kuvend. Për huamarrje është një shumë që është duke u proceduar dhe po besojmë që do të alokohet në gjashtëmujorin e dytë. Sa i përket grandit qeveritar nuk e ke pa askund që është 100% i shpenzuar, sepse kur të shpenzohet 100% ne nuk mundemi asnjë ujë me pi. Ndërsa sa i përket pyetjeve për ato shpenzimet zero janë prej të hyrave vetanake ku ato çdo muaj mbledhen dhe alokohen. Pas arkëtimit të të hyrave vetanake mbajmë takim, dhe ato alokohen nëpër programe që janë më urgjente. Për taksat përqindja është e vogël sepse operatorët e kanë deri në fund të vitit mundësinë që me i pagu dhe kjo vlerë rritet.

z.Rexhep Gashi: Lexoe te grandit qeveritar 92.21% është për buxhetin 2025 që është në realizim. Dhe te aktivitetet gjeodezike muk më dhae përgjigje fare për këtë pyetje.

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ: Përshëndetje. Sa ju përket inspektimeve gjeodezike nuk ka të bëjë për matje gjeodezike në teren, ka të bëjë me tarifa të rregullta që i ka agjensioni katasdral i Kosovës. Është normale që këtë gjashtëmujor është më pak mirëpo kjo mund të tejkalohet në gjashtëmujorin tjetër. Prej vitit 2019 duhet me sqaru për publikun që gjeodetët bëjnë matje vetëm për çështje të Komunës së Shtimes. Të gjitha projektet që i fillojmë ne kanë të përfshirë edhe matjet gjeodezike.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Sa i përket pyetjes te granti qeveritar po e shohë që keni problem me lexu raportin gjashtëmujor, aty është vetëm për periudhën e alokume. Të njejtën pyetje çdo mbledhje e bëjnë.

z.Rexhep Gashi: Për periudhën Janar-Qershor ende ska raport të detajuar me shifrat dhe të dhënat. Drejtori i DPUKGJ-së këto aktivitete gjeodezike e kuptova dhe e di se çfarë pune bëjnë. A ka raste kur operatorët nuk bëjnë fare matje gjeodezike sepse unë i di disa raste?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Po e hedhi në votim këtë pikë. Prezent janë 18 anëtarë.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për” me 5 vota “Kundër” dhe 2 vota “Abstenim” miratoi, Raportin Gjashtëmujor Buxhetor të Komunës së Shtimes për periudhën Janar-Qershor 2025.**

Pika 4

Raporti i Auditimit për Pasqyrën Vjetore Financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2024 nga ZKA

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Fjalën ja dha z. Besnik Ahmetit.

z. Besnik Ahmeti, DBF: Atëherë sipas këtij raporti janë gjithsej 9 rekomandime prej të cilave 5 janë të reja ndërsa 4 janë të përsëritura. Në vazhdim lexoi materialin si në vijim (shih dokumentin).

z. Reshat Mujota: Është hera e dytë që po na vjen si raport i kualifikuar. Në shuma dhe vlera ku përmenden edhe kodet, kemi pas probleme çdoherë. Te pjesa e subvencioneve qartë e thotë auditori që janë bërë shkelje. Drejtor si ndihesh kur del raporti i auditimit i kualifikuar, a te rastis me thënë këtu jemi duke bërë shkelje? Kjo i bije që me 4 rekomandime të përsëritura na u ka bërë shprehë me bërë shkelje.

znj. Adelina Beqaj: Vitin e kaluar e kemi pas të njejtin titull, ju raportin e kualifikuar e arsyetoni me kontratën kolektive e gjë që është duke ndodhur në gjithë Kosovën e jo vetëm në Komunën e Shtimes. E kemi edhe kategorin ekonomike adekuate që jemi duke punuar, edhe paramendoni qytetarë, auditori vetëm disa lëndë të ekzekutivit i ka kontrolluar po të i kishte kontrolluar të gjitha lëndët, jo vetëm këto 5 shkelje të reja që ja u ka gjetur por edhe një zero (0) ja kish shtu dhe ishin bërë 50, ka shkelje të kontratave në raport të auditorëve. Ju bëjë thirrje auditorëve që të vinë përsëri që të shohin prapë kontratat e juaja dhe punimet. Kryesues nuk është hera e parë që Komuna e Shtimes e përfiton grandin e performancës sepse edhe në vitin 2018 dhe 2020 e ka fituar.

z. Muhamet Ademaj: Nga ky raport shihen mangësitë, kërkoj që rekomandimet e auditorit të zbatohen pa vonesë.

z. Besnik Seferi: Jemi këtu që të ju japim rekomandime ekzekutivit që këto të gjetura të përmirësohen dhe mos të përsëriten. Shumë të përsëritura dhe të gjetura janë nga ish pushteti juaj. Po flasim për kontratën kolektive ku kjo kontratë është nënshkruar dhe aprovuar nga ish pushtetarët e juaj. Kur u tha për grantin e performancës është e vërtetë që Komuna e Shtimes ka qenë përfituese edhe më herët, mirëpo tani ka qenë mëse e vështirë që të jetë përfituese pasi që ka pasur borgje. Desha të theksoj pjesën e deklaratës së ish Kryetarit z. Naim Ismajli ku më ka prekur shumë ajo deklaratë rreth Entit Special. Ky projekt ka dy faza, ku qytetarët nuk e dinë vlerën që ka me u bërë në këtë ent. Ne si grup parlamentar rekomandojmë që këto të gjetura të jenë mundësi e përmirimit.

znj. Adelina Beqaj: I nderuar parafolës, nëse neve na akuzon për raportin e auditorit po ta rikujtoj që kemi 5 rekomandime të reja që d.m.th je keq tani, e jo në kohën e PDK-së. Ti në kohën e PDK-së ke kërkuar specifikim të projekteve tash nuk e di çka ka ndodhur me ty nuk po kërkon as specifikim të projekteve po e mbështet një raport të tillë dhe disa shkelje.

z. Besnik Seferi: Unë po ju them përsëri sa ju përket këtyre rekomandimeve janë si vazhdimsi e vendimeve që ju i keni marrë. Sa i përket specifikimit të projekteve unë prapë kërkoj specifikim të këtyre projekteve.

znj. Zejnije Veliu: Përshëndetje. Desha të cekim që prej fillimit të mandatit kemi pas 12 rekomandime, këtë vit kemi 9 rekomandime gjithsej. Gjatë vitit 2024 janë realizuar pagesat nga thesari në bazë të vendimeve gjyqësore për kontratat kolektive. Po të ishte paguar me kohë kontrata kolektive sot këto nuk do të diskutoheshin fare. Unë si këshilltare kam kërkuar një listë të projekteve që nuk janë mbyllë, ku janë 42 projekte që nga viti 2016 deri 2020. Nuk ka ardhë ky raport i kualifikuar nga qeverisja e tanishme por nga gabimet ose nga mos menaxhimi i asaj me kohë.

z. Asllan Beqaj: Përshëndetje. Për të gjitha ata që dojnë me ditë çka quajmë raport i kualifikuar e keni te faqja 25 e raportit e tregon se edhe me një gjetje raporti mundet me u konsideru i kualifikuar. Tash nëse flasim për të kaluarën, këto gjetje saktësojnë që kjo qeverisje është duke i menaxhuar shumë mirë punët. Gjatë raporteve të viti 2018, 2019 kam rastis me i parë shumë

gjetje të auditorëve. Kur flasim për investimet e mirë menaxhimin e keni prej dhjetorit të vitit 2021.

z.Reshat Mujota: Në mandatin 4 vjeçar asnjëherë raport të kualifikuar nuk kemi pas. Lexone në tërësi raportin. Auditori thotë se kemi vërejtur dy OJQ, klube sportive që kanë përfituar subvencione pa i plotësuar kriteret. Ju edhe jepni tokë edhe nuk raportoni normal që ti gjenë këto veti negative auditori. Pres nga kolegët tjerë të elaborojnë çështjet tjera se 9 të gjetura i kemi. nuk është vetëm një kontratë kolektive.

z.Rrahman Jakupi: Përshëndetje. Ky raport është për vitin 2024 ku janë 9 gjetje, u munduan që gjithë këtë raport ta lidhin me kontratën kolektive por janë edhe 8 gjetje tjera. U munduan që këtë raport ta vendosin mbi qeverisjen e kaluar. Dy raportet e vitit 2023 dhe vitit 2024, janë një sinjal për Prokurorin. Thatë që ka diferencë mes qeverisjes së kaluar, po pajtohem se ne kryesisht i kemi pas raportet e pa kualifikuara, për fat të keq askush nuk ju pyetë se si keni qenë, por si jeni. Nuk kemi të bëjmë vetëm me kontratat kolektive me vitin 2019, por kemi të bëjmë me vitin 2024. Për shkakë të kësaj keq qeverisje. auditorët shpresoj që në të ardhmen të hulumtojnë çështje tjera sidomos në fushën e infrastrukturës, shëndetësisë dhe të arsimit që ndoshta do të ishin 50 gjetje siç e tha edhe Adelina do të gjejnë gjetje të tjera. të cilat ne si opozitë veqse i dimë.

z.Adelina Beqaj: Me hy specifikisht në raportin e auditorit gjejmë keqmenaxhim te rregullimi i tregut të hapur, kanalizimin në zonën e biznesit ritenderim, asfaltimi i rrugëve, trotuarëve dhe ndriçimi në Rashincë, rruga "Cani", "Burimi", "Ferizaj", "Beqir Rushiti", "Trimat e Lirisë", "Qorrolli". Ndërtimi i sallës sportive në fshatin Zbore dhe Reçak, asfaltimi i rrugëve dhe ndriçimi në Vojnovc segment i rrugës "Jashari", "Mehmet Mehmeti", "Bashkim Emiri". Në total dalin miliona që janë keqpërdor nga ky pushtet.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Këtu nuk ka fare keqmenaxhim, më është përmend emri te 100 pikëshi te transparena buxhetore është e shkruar në dokumenta dhe mundeni me marrë me parë, kodet buxhetore i ka prekë përmbaruesi për shkakë të kontratës kolektive. znj.Veliu tha që janë 42 projekte që nuk i ka mbyllë kontratat pushteti i kaluar, unë e ftojë Prokurorin që të merrret me këto kontrata pse nuk janë mbyllë nga viti 2016 deri në vitin 2020. E shihni se kush ka qeveris dhe kush do të kërkoj votë nesër. Kërkoj falje nga qytetarët. Të gjitha ato shkelje qeverisja Aliu i ka dërguar në Prokurori, ne nuk kemi shkresë zyrtare që këto shkelje janë mbyllë si po i merrni ju këto informata që janë mbyllë.

z.Rrahman Jakupi: Kjo keq qeverisje ka kontraktu kompani private duke pas këtu 10 jurist, kanë ngritë disa kallëzime për gra shtatëzëna. Prokuroria ka bërë hetime dhe kallëzimet penale janë hedhë poshtë. Ju si qeverisje keni me dhënë përgjegjësi. Ky raport është i keq dhe për këto gjetje të 2023 dhe 2024 e ftojë Prokurorin hetuese të vije për hetime dhe të i hedhë poshtë këto pretendimet e ZKA-së.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Kontrata kolektive e ka çrregullu komplet buxhetin. Qytetarët e dinë që mbi 50 milion euro ka investime. Janë mbi 40 km asfalt, dhe mbi 40 km. ndriçim në Komunën e Shtimes. Mbi 17 milion euro projekte janë duke u investuar në Komunën e Shtimes. Unë publikisht e ftojë Prokuorin sepse ka lëndë që prej 2016 janë të pa mbyllura. 8 milion euro vetëm në infrastrukturë shkollore janë investuar. Subvencionet janë mbi 100 mijë euro në Kulturë. Tani i kemi 120 bursa për studentë. Z.Lumni Amrushi ka kërkuar në Komitetin për Politikë dhe Financa me i dërgu në Prokurori lëndët. Ipko e ka një antenë dhe ne kemi kërkuar me u zhvendos për shkakë të rrënimt të objekteve para Komunës që do të bëhet. Këtu e kemi një kontratë të Ipkos ku këto pagesat e qirasë shkojnë qe 5 vite në llogari private e jo të Komunës, e ftojë Prokurorin me u marrë me këtë çështje dhe me personin në fjalë.

z.Besnik Seferi: Atëherë qytetarë qëllimi i opozitës është me bërë politikë. Nuk e kisha leju këtë degradim të debatit Kryesues. Projektet janë parë dhe punët po ashtu. Ska çfarë të thuhet më shumë, po quditem me kolegun në fjalë z.Rrahman Jakupi kur thotë se jeni duke keqpërdor paranë publike. Unë jam për me ndihmuar nëse ka kesi shkelje. Jemi duke dal në diskutim që edhe populli e vëren se kush jeni ju dhe kush jemi ne.

z.Asllan Beqaj: Po thojnë që me folë vetëm për raportet 2024 por smundesh ti me ja dhënë një njollë të zezë kësaj qeverisje të mirë me një problem që e keni bërë vetë. Po thoni mos dilni jashtë

temav por ju lloj lloj roli po luani. Do të mbaheni mend për shumë por më së shumti për bllokues. Në secilin projekt e keni shfaqë egon e juaj për me i bllokuar, por nuk mundeni me i ndalë.

z.Lumni Amrushi: Përshëndetje. Ju kisha lutë Kryesues për qetësi. Mos të bëjmë filma pastaj me dalë me u arsyetu para qytetarëve. Sa i përket Prokurorisë që të kam thënë në Komitetin për Politikë dhe Financa është e vërtetë. Kushdo që ka diçka zyrtarishtë, le të vazhdojnë procedurat për shkeljet që janë bërë. Te pjesa që mu drejtove me gisht mua jam i gatshëm për nga ana ligjore me u përgjigjë i kam dokumentacionet për gjithçka e di çka është ajo, është pjesë e të kaluarës që nuk ka të bëjë me mua në atë vitë, unë jam i pastër dhe ju ftojë për gjithçka që keni të shkoni në Prokurori, çka do që keni gjetur gjatë këtyre 4 viteve depononi në Prokurori dhe Gjyqësi, dhe ballafaqohemi pa problem.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Unë nuk përmenda emra unë thashë e kam një kontratë, ku ne si institucion kemi bërë kërkesë për me tërheq Ipko antenën mbi kulmin e objektit që do të rrënohet së shpejti. Kur e kemi parë kontratën parat e paguara kanë shkuar në llogari private, për këtë arsye e ftojë Prokurorinë që të merret me këtë çështje, dhe këto para të i kthehen Komunës. z.Rrahman Jakupi e keni humbur të drejten për me fol gjatë kësaj seance.

z.Kadri Emini: Realisht ndjehem keq në keqpërdorim të mikrofonit. Të shkelësh rregulloren dhe të kalosh nga pika e rendit të ditës në çështje politike është shkelje e ligjit. E rëndësishme është me i parë komentet e drejtorëve në këto gjetje gjë që unë nuk i kam parë. Sinqerisht ne jemi në prag të fushatës dhe është mirë që ato dosje reciproke të i shohin qytetarët se kush i ka bërë këto keqpërdorime, mirëpo keqpërdorimi i mikrofonit në këtë formë është e pa pranueshme. Kuvendi në këtë rast mundet me i rekomandu Kryetarit që të mbajë një mbledhje me drejtorat dhe të i eliminojn këto të gjetura.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Është plani i veprimit që merret me këtë çështje, Kryetari dhe Drejtorët e kanë bërë planin e veprimit.

z.Rexhep Gashi: Gjatë këtij raporti ekzekutivi se besoj që e ka ndi vetën mirë. Hudhja e fajësisë para disa viteve nuk na e bënë nderë neve, gjatë gjetjeve të rekomandimeve 5 janë të reja ku është shqetësuese, jo vetëm Komuna jonë por edhe Komunitat tjera po e përmendin kontratën kolektive si shqetësuese. Pse nuk po bëhen pagesat me kohë? Këtu jemi me i ngritë shqetësimet tona.

znj.Zejniye Veliu: Pak më herët u tha se nuk po ju vjen marre me i përmend shkollat, nuk po më vjen marre sepse kur kemi ardhë në fillim të mandatit shkollat i kemi gjetë në gjendje tmerruese. E kemi gjetë vetëm 1 çerdhe tash i kem 6 çerdhe Në këtë kohë shkolla e Lagjes së Pajtimit ka qenë me stufa ndërsa tani është me nxemje elektrike. Te arsimit 90% e Drejtorëve të shkollave kanë qenë politikë gjë që tregon se ka qenë arsimit i politizuar, ndërsa tani asnjë nga Drejtorët nuk është anëtarë i kësaj partie.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Përshëndetje. Këtë ndërhyrje po e bëjë për hir të qytetarëve, po më bëhet qejfi që zgjedhjet po vinë, janë 3 asambleistë që e kanë degraduar rëndë asamblenë. Kthehemi te pika e rendit të ditës. Raporti i kualifikuar është titulli për këtë vitë, arsyeja është të gjeturat e periudhes 2016-2020 ku janë 42 projekte të pa mbyllura, pastaj është kontrata kolektive, pastaj marrja e vendimeve të shpronësimeve. Komunën tonë e kanë ngulfatur 6-8 milion borgje. Përmbaruesi çdo javë vjen i merrë pagesat me aktvendim të gjykatës, d.m.th ne e kemi trashëguar një qeverisje nga shtëpijak të këqinj. Për qeverisjen tonë po shihen rezultatet që në vitin e parë e kemi fituar çmimin “ALDA” për qeverisje të shkëlqyer. Në vitin e dytë kemi fituar grantin e performancës. Ne kemi mundur që çdo vitë me fitu por pengesë ka qenë ish-qeverisja. Në Prokurori ka dokumenta shumë që i kemi dërguar dhe vazhdojmë të i dërgojmë.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, me 13 vota “Për” 4 vota “Kundër” dhe 2 vota “Abstenim” miratoi, Raportin e Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2024, nga Zyra Kombëtare e Auditimit.**

Pika 5

Plani i Veprimit nga Raporti Vjetor i Auditimit të Pasqyrës Vjetore Financiare 2024 për Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, me 13 vota “Për” 3 vota “Kundër” dhe 3 vota “Abstenim” miratoi, Planin e Veprimit nga Raporti Vjetor i Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare 2024 për Komunën e Shtimes**

Pika 6

Draft – Plani për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin Ferizaj – Gjilan
Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, me 16 vota “Për” 0 vota “Kundër” dhe 2 vota “Abstenim” miratoi, Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin Gjilan-Ferizaj.**

Pika 7

Deklaratë mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Ju rekomandoj që kjo pikë të votohet unanimisht. Në vazhdim lexoi materialin. (shih dokumentin).

***Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht, miratoi Deklaratën mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë.**

Pika 8

Pyetje-Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Ademaj: Kam këtë pyetje, sa është numri i lokaleve publike që nuk janë pranuar teknikisht nga Komuna e Shtimes?

z.Reshat Mujota: Pyetje për ty Kryesues ne kemi marrë vendim qysh në vitin e dytë të këtij mandati për formimin e Komisioneve edhe për Komisionin e këshillave lokale, ai Komision kurrë nuk është ftuar, ti si Kryesues ke qenë i obliguar me e ftu atë Komision dhe me fillu punën. Ai komision është formu dhe e kryti mandatin pa e bërë asnjë punë, pse nuk janë bërë këshillat e fshatrave? Çështja tjetër te Kryetari për Komisionin e emërimit të objekteve publike dhe Sakrifica e Reçakut, ku Komisioni Sakrifica e Reçakut nuk është formuar fare, pse nuk është formuar ky Komision? Ndërsa te Komisioni për emërtimin e objekteve publike deri ku ka mbërri ky Komision, ku janë ngecjet le ti raporton Kuvendit sepse është obliguese me i raportu? Kemi pas shqetësime të disa familjarëve, kur ju keni kthyer përgjigje.

z.Rrahman Jakupi: E shprehi shqetësimin tim se si është ndalu emërtimi i Shtëpisë së Kulturës me emrin e të ndjerit z.Ahmet Qeriqi, pyetje për Kryetarin, pse keni ndërhyer në momentin e fundit në Komision që mos me u emërtu Shtëpia e Kulturës me emrin e të ndjerit z. Ahmet Qeriqi?

z.Besnik Seferi: Kryetari Aliu asnjëherë nuk ka ndikuar e as un asnjëherë nuk kam qenë i ndikuar që në këtë Komision të marrë vendim. Gjithsesi pjesë e Komisionit kanë qenë edhe disa anëtarë këtu dhe nuk kemi përfundim sepse po mundohen politikisht që me i bërë të mira kësa familje.Të dy emrat e të ndjerëve z.Fahri Hysaj dhe z.Ahmet Qeriqi si dhe familjet e tyre kanë karakter të jashtëzakonshëm për Komunën e Shtimes. Nuk du me ma laku emrin sepse unë nuk i kam marrë idetë e z.Aliut sepse nuk ka pas të tilla asnjëherë. Ne kemi qenë të mendimit që Shtëpia e Kulturës të emërtohet me emrin e të ndjerit z.Fahri Hysaj. Ndërsa emrin e të ndjerit z.Ahmet Qeriqi të ja lëmë Bibliotekës së Qyetit.

z.Muhamet Ademaj: Edhe unë kam qenë anëtarë i këtij Komisionit, shumicen e punëve i kemi kryer. Unë së bashku me Besnikun kam ngecur këtu, tek emërtimi i Shtëpisë së Kulturës, ku emri i të ndjerit z.Ahmet Qeriqit ka ardhë më vonë. Ne nuk kemi pasur kurrfarë presioni nga ana e Kryetarit. Më vjen keq që nuk kemi mundur të i emërtojm të gjitha objektet në Komunën e Shtimes. Vjen tani Komisioni i ri dhe besoj që ai do të i emërtoj.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: E falenderoj z.Seferin dhe z.Ademaj që janë pjesë e Komisionit. Sa i përket kompetencave të mija bashkë me legjislativin ne e kemi kriju Komisionin për emërtimin e objekteve publike. Unë e kam kryer obligimin tim ligjor dhe moral ndaj kërkesës së atyre

familjeve të nderume si dhe ndaj peticioneve që i kanë bërë qytarët. Dikush ka vendos me shpërdorur detyrën që ju ka dhënë, le ta dinë edhe këto familje që unë do të i thërras në takim së bashku me anëtarët e Komisionit që do të ju jap sqarimet e nevojshme. Ndikimi im ka qenë zero. Ju bëj thirrje familjarëve të lexojnë procesverbalin e mbledhjeve të këtij Komisionit dhe shpjegimet e anëtarëve. Ky person z.Ruzhdi Jashari po e dëshmon që nuk e ka meritë këtë besim dhe po e keqpërdor këtë besim që ja kemi dhënë në mënyrën më të keqe të mundshme. Po tenton me krijë përçarje mes meje, ekzekutivit dhe këtyre familjeve. Unë nuk kam ndërhy por Komisionin ka pas mirkuptim që në mënyrë unanime kanë bërë emërtimin e të gjitha objekteve. Nuk mendoj që familjet kanë me ra pre e këtyre keqpërdorimeve që i ka bërë z.Jashari, ndikime nuk ka dhe nuk ka me pas. Besoj që këto familje dhe qytetarët e kanë të qartë tendencën e këtij personi.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Ju kisha lutë që mos të manipulojm me familjet. Ndërsa z.Ruzhdi Jashari është pa ftesë të Kryesuesit në Kuvend.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora: 13:10h.

Procesmbajtës
Sadberë Halili



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

